



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 152, datë 29.10.2012

**PËR MARRJEN E MASAVE KORRIGJUESE NGA INSPEKTIMI I USHTRUAR
PRANË BYROSË SHQIPTARE TË SIGURIMIT**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 13, 14, pika 23, dhe nenit 32 të Ligji nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes dhe Departamentit të Çështjeve Juridike, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

K O N S T A T O I S E :

Pranë Byrosë Shqiptare të Sigurimeve është ushtruar inspektim lidhur me aktivitetin e ushtruar prej saj gjatë periudhës së viteve 2009 deri në 2011, (bazuar në programin e Inspektimit nr. 837 prot, datë 03.05.2012, si dhe shtesës së programit nr. 887 prot, datë 09.05.2012). Nga ky inspektim është konstatuar se Byroja nuk ka respektuar dispozita të caktuara të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009, “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

Byroja është vënë në dijeni të shkeljeve të konstatuara nga raporti përfundimtar i inspektimit.

Për sa më sipër Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, bazuar në nenin 32 të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006, “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”,

V E N D O S I:

1. Byroja Shqiptare e Sigurimit të depozitojë në Autoritet brenda datës 15.11.2012, një raport të detajuar për masat që do të marrë për eliminimin e shkeljeve të evidentuara në raportin e inspektimit, ku të bëjë një analizë të thelluar të situatës duke përcaktuar rrugët, mënyrat e përmirësimit të saj si dhe afatet për korrigjimin dhe eliminimin e këtyre shkeljeve.
2. Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve të marrë masa ndaj personave përgjegjës dhe drejtuesve, dhe të propozojë mënyrën organizimit të BSHS, me qëllim plotësimin e masave të përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi.
3. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Enkelelda SHEHI